



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 pragrafi (1) alinea 22 dhe nenit 20 paragrafi (1) alinea 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-107 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-107 datë 10.3.2023 nga drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me Konkluzionin, ark. nr.02-1099/3 datë 13.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 10-të mbajtur më 13.03.2023 miratoi:

AKTVENDIM
për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen
e lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar, nr.08-101 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzionin, ark.nr.02-1007/16 datë 8.3.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-107 datë 7.3.2023 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj SHTR RADIO KAVARCI SHPKNJP KAVADAR, nr.08-101 datë 5.1.2015, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1019/1 datë 6.3.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë (lëshuar) nga Agjencia, nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, respektivisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen për transmetim në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë më 9.3.2023 drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-107 datë 9.3.2023, njoftim se nëse nuk paguan kompensimin (tarifën) vjetore për lejen për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 9.3.2023 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i Financave dhe Logjistikës, është dorëzuar Njoftimi me nr.ark.05-1019/2 datë 9.3.2023 që SHTR RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar, më 8.3.2023 ka kryer pagesën në shumë prej 14.116,00 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) denarë, me të cilën transmetuesi e ka paguar në tërësi tarifën vjetore për transmetim në radio.

Në lidhje me këtë që u tha më lartë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) alinea 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 nga Ligji për Shërbime

Уп1 Бр.08-114

Скопје 14.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ

Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurë të përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-107 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-107 datë 10.3.2023 nga drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1099/3 datë 13.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 10-të mbajtur më 13.3.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes. Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor vendimi si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshilli juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).